

BULETIN BINJAKËZIMI

Buletin tremujor i publikuar nga Projekti i Binjakëzimit 'Mbështetje për Statistikat' në Kosovë - projekt i financuar nga programi i Binjakëzimit i Bashkimit Evropian për shtetet IPA

Rritja e përputhshmërisë me standardet e BE-së në fushën e statistikës

> Ky është buletini i dytë i Projektit të Binjakëzimit, financuar nga BE-ja, "Mbështetje për Statistikat" në Kosovë (KS 12 IB ST 01).

Ky projekt i financuar nga BE-ja implementohet nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) në bashkëpunim me Statistikat e Danimarkës. Gjithashtu, janë të përfshirë ekspertë nga Finlanda, Lituania, Irlanda Veriore dhe Italia.

Projekti sapo ka përfunduar 6 mujorin e parë të implementimit. Ky buletin do t'ju informojë për progresin e projektit dhe aktivitetet, që janë realizuar deri tani.

> Informacione mbi projektin

Projekti i Binjakëzimit, i financuar nga BE-ja, zgjat 24 muaj, deri në dhjetor të vitit 2015, dhe ka një buxhet prej 1.5 milion EUR. Projektet e binjakëzimit janë një iniciativë e Bashkimit Evropian, me qëllimin të ndihmojë vendet e reja anëtare, vendet kandidate dhe vendet fqinje, të fitojnë shkathtësitë dhe përvojat e nevojshme për përvetësimin, zbatimin dhe fuqizimin e legjislacionit të BE-së. Ky Projekt Binjakëzimi ka për qëllim të përkrahë ASK-në në prodhimin dhe diseminimin e statistikave sipas standardeve të BE-së.

> Projekti mbulon katër komponente:

Komponenti 1. Një sistem cilësie për statistikë. Ky komponent ka për qëllim të fuqizojë kapacitetin e përgjithshëm të ASK-së.

Komponenti 2. Llogaritë Kombëtare. Qëllimi do të jetë rritja e përputhshmërisë me standardet aktuale të BE-së, me fokus të veçantë në fillimin e prodhimit të Llogarive Kombëtare në baza tremujore.

Komponenti 3. Statistikat e Biznesit. Projekti, mes të tjerash, do të punojë me ASK-në në përmirësimin e Statistikave Strukturore të Ndërmarrjeve, prodhimin e indikatorëve afatshkurtër dhe përmirësimin e Regjistrat Statistikor të Bizneseve.



■ Takimi i dytë i Këshillit Drejtues të Projektit

Komponenti 4. TI dhe Diseminimi. Aktivitetet në komponentin 4 janë dizajnuar për të përmirësuar sistemet e TI-së në ASK dhe cilësinë e diseminimit të statistikave nga ASK-ja. Edhe një projekt tjetër me SIDA (Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar) është duke punuar në të njëjtën fushë, por është arritur një skemë e mirë bashkëpunimi tashmë për të parandaluar dyfishimin e aktiviteteve nga dy projektet. Projekti i SIDA-s do të përqëndrohet në TI, ndërkohë që Projekti i Binjakëzimit në pjesën e Diseminimit të komponentit 4.

> Këshilli Drejtues

Projekti, që ka filluar më 9 Dhjetor 2013, ka formuar një Këshill Drejtues, i cili u takua për herë të parë në Mars të vitit 2014. Këshilli Drejtues do të takohet çdo tre muaj dhe do të përcjellë implementimin e projektit nga afër. Anëtarët e këtij Këshilli janë: Z. Isa Krasniqi, Kryeshef Ekzekutiv në ASK (Kryesues i Këshillit), Znj. Angeliki Votsoglou, Task Manager, Zyra e BE-së në Kosovë, Znj. Burbuqe Kelmendi, Koordinatorë për Binjakëzim, Zyra e BE-së në Kosovë, Znj. Hakile Xhaferi, Kryetare e Këshillit Statistikor, Znj. Valmira Rexhëbeqaj, përfaqësuese e Ministrisë së Financave në Këshillin Statistikor, Z. Kastriot Halili, Ministria e Integritetit Evropian, Z. Ilir T. Berisha, Udhëheqës i projektit në ASK, Znj. Teuta Zyberi, Homologe e këshilltarit rezident të binjakëzimit në ASK, Z. Lars Thygesen, Udhëheqës projektit nga vendet anëtare, Statistikat e Danimarkës, Z. Jesper Ellemose Jensen, Zëvendës-udhëheqës i projektit nga vendet anëtare, Statistikat e Danimarkës, Z. Per Knudsen, Këshilltar

Rezident i Binjakëzimit, Statistikat e Danimarkës, Znj. Nora Zogaj, Asistente, dhe Znj. Catrin Karling, SIDA (vëzhgues)

> 16 misione për 6 muaj

16 misione janë realizuar deri tani, 10 prej tyre gjatë 3 muajve të fundit. Projekti po shënon progres dhe ka realizuar misione në katër komponentet. ASK-ja dhe ekspertët nga vendet anëtare kanë punuar në fusha si: plani statistikor i punës, udhërrëfyesit mbi cilësinë, llogaritë kombëtare në baza tremujore, statistikë strukturore të ndërmarrjeve, indikatorët e prodhimit industrial, statistikë afatshkurta, regjistri statistikor i bizneseve dhe databaza e diseminimit. Gjatë 6 muajve të projektit, ka pasur ekspertë nga Danimarka, Finlanda dhe Lituania, të cilët kanë ofruar ekspertizën e tyre në fushën e Cilësisë, Llogaritë Kombëtare, Statistikat e Biznesit, dhe TI & Diseminimit.

Tremujori i dytë i projektit ka qenë mjaft intensiv dhe të gjithë ekspertët nga vendet anëtare dhe profesionistët në ASK kanë punuar shumë. 25 misione të tjera janë planifikuar për 6 muajt e ardhshëm – përsëri, në katër komponentet.

Per Knudsen Resident Twinning Adviser (RTA)

EU Twinning Project
Support to Statistics in Kosovo
Tel. (RKS) +386 (0)49819307
Tel. (DK) +45 28357071

Project information is available from the website

WWW.DST.DK/KOSOVO



This project is funded by the European Union



This project is implemented by Statistics Denmark